



# Prospekt



**CREDINS**  
PENSION



# **PROSPEKT**

Fondi i Pensionit Vullnetar  
“Credins Pension”

Publikuar më Prill 2023

Prospekti i Fondit të Pensionit Vullnetar “Credins Pension” (në vijim “Fondi”) i jep kontribuesve një paraqitje të rregullave të Fondit, qëllimit dhe parimeve të investimit të Fondit, si dhe i ndihmon kontribuesit të marrin vendimin për të investuar në këtë Fond.

Të gjithë kontribuesit që kanë qëllim të anëtarësohen në Fondin e Pensionit Vullnetar, këshillohen të lexojnë me kujdes informacionin e paraqitur në Prospektin e Fondit.

Informacioni mbi kontribuesit e Fondit është tërësisht konfidencial.

Organizimi dhe administrimi i fondit të pensionit kryhet ekskluzivisht nga Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit si pjesë e veprimtarisë së “Credins Invest” sh.a..

Aktualisht shoqëria “Credins Invest” sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve (në vijim Shoqëria Administruese) ka si objekt të aktivitetit të saj:

- Administrimin e Fondeve të Pensionit Vullnetar, bazuar në licencën nr.3, datë 23.11.2011;
- Administrimin e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive me ofertë publike, bazuar në licencën me nr.3, datë 30.05.2016;
- Administrimin e Fondeve të Investimeve Alternative vetëm për klientë profesionistë dhe të kualifikuar, bazuar në vendimin nr. 207, datë 29.12.2020.

Shoqëria ka nën administrim Fondin e Pensionit Vullnetar “Credins Pension”, Fondin e Investimit “Credins Premium”, Fondin e Investimeve Alternative “Sea Land Alternative Investment Fund”- Shoqëri Komandite SIK dhe Fondin e Investimeve Alternative “Green View Alternative Investment Fund” - Shoqëri Komandite SIK.

Asetet e Fondit të Pensionit ruhen të ndara nga asetet e Fondeve të tjera që shoqëria ka nën administrim, si dhe nga asetet e Shoqërisë Administruese.

Në këtë prospekt përshkruhen karakteristikat e Fondit të Pensionit Vullnetar “Credins Pension”.

## TABELA E PËRMBAJTJES

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME .....	04
1.1 TË DHËNA HISTORIKE .....	04
1.2 DETAJE TË PËRGJITHSHME TË FONDIT .....	05
2. ASPEKTET KRYESORE TË POLITIKËS SË INVESTIMIT .....	06
2.1 OBJEKTIVI .....	06
2.2 PROFILI I INVESTIMIT TË FONDIT .....	06
2.3 ALOKIMI STRATEGJIK I ASETVE .....	07
2.4 KUFIZIMET E INVESTIMIT .....	07
3. ASPEKTET KRYESORE TË POLITIKËS SË MENAXHIMIT TË RISKUT .....	07
3.1 IDENTIFIKIMI I RISKUT .....	08
3.2 RREGULLAT E ADMINISTRIMIT TË RISKUT .....	10
4. PERFORMANCA E FONDIT DHE INFORMIMI I PUBLIKUT .....	11
5. KONTRIBUTET E ANËTARËVE NË FONDIN E PENSIONIT .....	11
6. TRAJTIMI FISKAL .....	12
6.1 TRAJTIMI FISKAL I FONDIT .....	12
6.2 TRAJTIMI FISKAL I KONTRIBUTEVE TË BËRA NGA ANËTARËT .....	12
6.3 TRAJTIMI FISKAL I KONTRIBUTEVE TË BËRA NGA PUNËDHËNËSI .....	12
6.4 TRAJTIMI FISKAL I PËRFITIMEVE TË MARRA NGA ANËTARI .....	12
7. PAGESA E PENSIONEVE .....	13
7.1 PAGESA E PENSIONIT SIPAS KRITEREVE TË PARASHIKUARA ME LIGJ .....	13
7.2 TËRHEQJA E PARAKOHSHME .....	13
7.3 FONDI I PENSIONIT VULLNETAR ËSHTË I TRASHËGUESHËM .....	14
7.4 PROCEDURA PËR TËRHEQJEN E ASETVE NGA LLOGARIA INDIVIDUALE .....	14
8. PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES SË ANËTARËSISË NË FONDIN E PENSIONIT .....	14
9. TRANSFERIMI I LLOGARISË INDIVIDUALE .....	15
10. TARIFAT E SHOQËRISË ADMINISTRUESE .....	15
11. DEPOZITARI .....	16
12. EMRI DHE SELIA E AUDITUESIT TË JASHTËM .....	16
13. PËRBËRJA E ORGANEVE DREJTUESE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE .....	16
14. DELEGIMI I FUNKSIONEVE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE .....	19
15. NDRYSHIMET NË PROSPEKT .....	19
ANEKSI 1 PËRKUFIZIME TË TERMAVE KRYESORE .....	20
ANEKSI 2 SHEMBUJ ILUSTRATIVË TË SKEMËS SË PENSIONIT TË FONDIT .....	21

## 1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Ligji për Fondet e Pensionit Vullnetar miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe rregulloret mbështetëse, të nxjerra nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, janë baza e aktiviteteve dhe operacioneve të Fondit. Kërkesat e ligjit dhe rregulloreve përbëjnë një pjesë integrale të Prospektit.

Në të gjitha rastet që kërkohen nga ligji, ndryshimet dhe shtesat në prospekt do të marrin miratimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Shoqëria Administruese garanton që do të zbatojë legjislacionin në fuqi dhe:

- Asetet e Fondit nuk do mund të jenë objekt i pretendimeve ose ekzekutimeve, të kryera në emër dhe për llogari të kreditorëve të Shoqërisë Administruese.
- Fondi nuk mund të jetë pjesë e procedurës së falimentimit.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (me adresë Rruga “Dora D’Istria”, Nr.10 P.O. Box 8363, Tiranë, Shqipëri) ushtron mbikëqyrjen mbi aktivitetet e Shoqërisë Administruese, të Fondit dhe Depozitarit.

Prospekti, Raportet periodike dhe çdo informacion shtesë të kërkuar nga anëtari, do të vihen në dispozicion të Anëtarëve pa pagesë, pranë zyrave qendrore të Shoqërisë Administruese, në adresën Rr. Nikolla Tupe, nr.1, kati 3, Tiranë, Shqipëri, pas një kërkesë me shkrim nëpërmjet postës elektronike dhe në faqen zyrtare të Shoqërisë.

Prospekti i Fondit do të jetë i disponueshëm edhe në degët e Bankës Credins.

Të gjitha informacionet e mësipërme, së bashku me çmimin e kuotës dhe vlerën neto të aseteve për kuotë, publikohen rregullisht në faqen zyrtare të internetit të Shoqërisë Administruese.


Për çdo ankesë jeni të lutur ta dërgoni me shkrim në adresën zyrtare postare të Shoqërisë Credins Invest sh.a., ose duke plotësuar online në faqen zyrtare të shoqërisë, formën në rubrikën “Sugjerime dhe Ankesa”, në adresën elektronike: [ankesa@credinsinvest.net](mailto:ankesa@credinsinvest.net). Ankesat do të shqyrtohen nga strukturat përkatëse, dhe ju do të merrni përgjigje brenda 20 ditëve pune pas pranimit të ankesës.

### 1.1 TË DHËNA HISTORIKE

Në grafik paraqitet e ardhura historike e Fondit Credins Pension. Tarifa e administrimit i zbritet të ardhurës vjetore të Fondit duke rezultuar në të ardhurën vjetore neto. Vlera Neto e Aseteve të Fondit më 31.12.2022 rezultoi në 1,688,407,700.10 Lekë.

#### E Ardhura Neto Vjetore

*E ardhura historike paraqitet vetëm për arsye ilustruese dhe nuk duhet të konsiderohet si një garanci për të ardhmen.*



**1.2 DETAJE TË PËRGJITHSHME TË FONDIT:**

FORMA LIGJORE	Fondi i Pensionit është një grup asetesh, i krijuar në bazë kontrate dhe pa personalitet juridik, i përbërë nga kontributet dhe investimi i tyre, pasi janë zbritur të gjitha tarifatat. Fondi i Pensionit zotërohet bashkërisht nga disa persona, në pronësi të ndarë dhe ku pjesët e pronësisë përfaqësohen nga kuota në fondin e pensionit. Çdo kuotë përfaqëson pronësinë e pjesës përpjesëtimore të aseteve, të cilat ndodhen në fondin e pensionit.
SHOQËRIA ADMINISTRUESE	Credins Invest sh.a. - Shoqëri Administruese e Fondeve
THEMELIMI DHE REGJISTRIMI	Themeluar dhe Regjistruar pranë QKB në datë 31.10.2005
SELIA E REGJISTRUAR E	Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga “Nikolla Tupe”, Nr.1, Kati 3, Tiranë, Shqipëri
DATA E KRIJIMIT TË FONDIT	Vendimi nr. 173 i Bordit të AMF, datë 13.11.2011
PROSPEKTI I PARË	Miraturar me Vendimin nr. 173, Datë 13.12.2011
DATA E FILLIMIT TË VEPRIMTARISE SË FONDIT:	01.01.2012
KONTRIBUTET NË FOND	Asetet e Anëtarit në një fond pensioni përbëhen nga kontributet në para, të bëra në emër dhe për llogari të Anëtarit dhe nga kthimi i investimit të bërë me këto kontribute, pas zbatimit të zbritjeve të nevojshme. Shoqëria Administruese konverton në kuotë pensioni kontributet e investuara. Çdo kuotë pensioni përfaqëson një pjesë përpjesëtimore pronësie në secilën nga asetet e fondit të pensioneve. Vlera totale e kuotave në fondin e pensionit është gjithmonë e barabartë me vlerën totale neto të aseteve të fondit të pensionit. Grupi i aseteve të fondit të pensionit është në pronësi vetëm të Anëtarëve të fondit.
VITI FINANCIAR I FONDIT	Fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor
DEPOZITARI	Tirana Bank sh.a.
NUMRI I LICENCËS NGA AMF	Licenca Nr. 2 Datë 06.06.2019 (pa afat)
WEBSITE	<a href="http://www.credinsinvest.com">www.credinsinvest.com</a>

## 2. ASPEKTET KRYESORE TË POLITIKËS SË INVESTIMIT

Politika e investimit e Fondit të Pensionit është miratuar nga Këshilli i Administrimit dhe është pjesë e këtij Prospekti. Politika e investimit është objekt rishikimi nga Shoqëria Administruese dhe ndryshimet e saj duhet të marrin miratimin e Këshillit të Administrimit përpara se të përfshihen në Prospektin e Fondit. Prospekti i Fondit të Pensionit Vullnetar “Credins Pension” është miratuar nga AMF. Shoqëria informon Anëtarët e Fondit për çdo ndryshim të politikës së investimit të aseteve të Fondit të paktën një muaj përpara këtyre ndryshimeve nëpërmjet mjeteve elektronike. Çdo ndryshim i politikës së investimit do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Shoqërisë Administruese.

### 2.1 OBJEKTIVI

Investimi i aseteve të Fondit synon optimizimin e kthimit nga investimi duke minimizuar riskun. Karakteristikat e Fondit në radhë prioriteti janë si më poshtë:

Siguria – investimi i aseteve të Fondit në instrumenta me kredibilitet të lartë siç janë titujt qeveritarë;

Likuiditeti - ruajtja e një niveli të mjaftueshëm likuiditeti për t’iu përgjigjur të gjitha detyrimeve të pensioneve.

Kthimi nga investimi – portofoli i investimeve do të ndërtohet nga obligacione afatgjatë të emetuara dhe garantuara nga Republika e Shqipërisë me synimin e maksimizimit të fitimit të kushtëzuar nga kufijtë e riskut dhe likuiditetit.

### 2.2 PROFILI I INVESTIMIT TË FONDIT

Duke u nisur nga fakti që detyrimet e Fondit janë afatgjata, prirja e profilit të investimit do të jetë afatgjatë, si më poshtë:

<b>Horizonti i Investimit:</b>	Afatgjatë
<b>Niveli i Tolerancës ndaj Riskut të Investimit:</b>	Konservative
<b>Miksi i Portofolit/Preferenca e Investimit</b>	Kthimi optimal

#### **Objektivi i Investimit:**

Fondi synon optimizimin e normës së kthimit duke minimizuar riskun, ruajtjen e vlerës së kapitalit dhe likuiditetit për të siguruar të ardhura të mjaftueshme gjatë periudhës së pensionit.

#### **Strategjia e Investimit:**

Të gjitha investimet do të kryhen duke mbajtur parasysh ruajtjen e vlerës së kapitalit dhe të një niveli të mjaftueshëm likuiditeti, për të përmbushur të gjitha detyrimet e tashme dhe të ardhshme në momentin që këto të fundit bëhen të pagueshme. Fondi do të investojë kryesisht në obligacione afatgjatë të shtetit shqiptar për shkak të kohës së largët të daljes në pension.



## 2.3 ALOKIMI STRATEGJIK I ASETEVE

Shoqëria Administruese do të synojë të respektojë objektivin e përcaktuar më poshtë për alokimin strategjik të aseteve:

Tabela 1:

Klasa e aseteve	Objektivi
Bono thesari dhe obligacione të emetuara dhe të garantuara nga Qeveria e RSH.	99%
Depozita, mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	1%
Bono thesari dhe obligacione të shteteve anëtare të BE të denominuara në monedhën EUR	0%

## 2.4 KUFIZIMET E INVESTIMIT

Asetet e fondit nuk mund të investohen në:

- Aksione, obligacione dhe letra të tjera me vlerë, që nuk janë të listuara në bursë, në tregun ndërbankar apo në tregje të tjera të rregulluara;
- Asete që nuk mund të shiten apo të transferohen;
- Instrumenta financiare derivative, përveç rasteve për mbrojtjen nga risku i kursit të këmbimit, normave të interesit apo nga risqe të ngjashme;
- Asete fizike, që nuk kuotohen në mënyrë të rregullt në tregje të organizuara dhe për të cilat vlerësimi është i pasigurtë si antika, punime arti, mjete motorike etj;
- Aksione, obligacione dhe letra të tjera me vlerë, të emetuara nga:
  - çdo aksionar i Shoqërisë Administruese;
  - depozitar i Fondit;
  - çdo person, palë e lidhur me entitetin e radhitur në pikat (a) dhe (b) të këtij paragrafi;
- Kuota të fondeve të investimeve të administruara nga vetë Shoqëria Administruese;
- Letra borxhi të emetuara nga vetë punëdhënësi.

## 3. ASPEKTET KRYESORE TË POLITIKËS SË MENAXHIMIT TË RISKUT

Në përputhje me ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar”, skema e pensionit vullnetar është me kontribute të përcaktuara ku përfitimet nuk janë të garantuara. Si rrjedhojë riskun e investimit në fond e mbart Anëtari.

Menaxhimi i riskut është një proces që përbëhet nga identifikimi i ekspozimit ndaj riskut, vendosja e intervaleve të lejuara të këtyre ekspozimeve, matja e vazhdueshme e ekspozimeve, dhe ekzekutimi i axhustimeve të duhura sa herë nivelet e ekspozimit gjenden jashtë intervaleve të caktuara.

### 3.1 IDENTIFIKIMI I RISKUT

Siç shihet në alokimin e portofolit në Tabelën 1, obligacionet dhe bonot e Republikës së Shqipërisë do të zënë pjesën më të madhe në portofol. Këto tituj janë të garantuara plotësisht nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, dhe për rrjedhojë ato kanë riskun e kredisë shumë të ulët. Si çdo letër tjetër borxhi ato përmbajnë riskun nga norma e interesit. Një rritje e normave të interesit sjell uljen e vlerës së tregut për këto instrumenta.

Një menaxhim risku efektiv nënkupton ndarjen e ekspozimeve të riskut në kategori specifike që reflektojnë karakteristikat e tyre dalluese.

#### RISQE TË LIDHURA ME INVESTIMIN

Megjithëse lista nuk është ezauruese, shumë nga ekspozimet e portofolit përbëhen nga: risku i tregut (risku nga normat e interesit, kurset e këmbimit), risku i kreditit, risku i likuiditetit, risku operacional, etj. të cilat janë të shpjguara si më poshtë:

- **Risku i Tregut**

Risku i tregut përbëhet nga: risku i normave të interesit, risku i luhatjes së kurseve të këmbimit. Rritja e normave të interesit sjell zvogëlimin e vlerës së tregut të asetëve të përbëra nga obligacionet dhe bonot. Nga ana tjetër një ambient me norma të ulëta interesi përbën një sfidë për menaxherin e portofolit pasi duhet të realizojë një normë kthimi të kushtëzuar nga detyrimet e fondit.

Në rastin e një shembulli të ndryshimit të normave të interesit në tregun vendas me rritje me 1%, një obligacion 100 lekë me kohëzgjatje 3 vite, nëse mbahet në portofolin e vlefshëm për shitje, mund të ketë përafërsisht një rënie të vlerës së tregut në rast të shitjes para kohe të tij, me rreth 3% ndaj total vlerës së obligacionit.

- **Risku i kursit të këmbimit**

Fondi e ka të lejuar dhe mund të investojë edhe në obligacione të emetuara në EUR dhe të garantuara nga shtetet anëtarë të BE. Objektivi i Fondit për investime në monedhën EUR aktualisht është 0%. Nëse Fondi do të ketë alokim në këtë klasë asetesh do të kishte riskun e luhatjes së kursit të këmbimit. Ekspozimet në asete në valutën EUR përmbajnë riskun e lëvizjes së pafavorshme të kursit të këmbimit që mund të sjellin një normë kthimi më të ulët.

- **Risku i Kredisë**

Një apo disa emetues të titujve të mbajtur në portofol nga Fondi mund të dështojnë në pagesën e detyrimeve të interesit apo principalit. Gjithashtu, përkeqësimi i cilësisë së kreditit të titujve sjell përkeqësime të likuiditetit dhe zvogëlim të Vlerës Neto të Aseteve. Rritja e marzhit në krahasim me një emetues “risk-free” (norma e kthimit e ofruar nga Qeveria e Shqipërisë) gjithashtu sjell zvogëlim të vlerës së letrës me vlerë, si rrjedhojë dhe përkeqësim të Vlerës Neto të Aseteve. Fondi ka kryesisht ekspozime ndaj qeverisë shqiptare e cila konsiderohet me risk shumë të ulët krediti.

- **Risku i Likuiditetit**

Risku i Likuiditetit përbën pamundësinë për të likuiduar një aset në kohë apo për ta likuiduar atë me një normë kthimi pa humbje. Në disa raste tregu për një instrument financiar mund të boshatiset i gjithi, duke sjellë pamundësinë për ta tregtuar atë instrument. Gjithashtu, shitja e sforcuar e një asemi për të përmbushur nevojat për likuiditet mund të rezultojë me një normë kthimi me humbje. Kjo si pasojë e marrjes në treg të një çmimi shitje për titullin që mund të jetë më i ulët sesa çmimi që vlerësohet çdo ditë nga shoqëria për portofolin e titujve të klasifikuar si të vlefshëm për shitje, ku diferenca (spread) mes çmimeve paraqet edhe kushtet e tregtueshmërisë dhe likuiditetit të tregut financiar.

- **Risku i Agjencisë**

Risku i Agjencisë është dëmi që mund t'i shkaktohet fondit nga vendimmarrje të qëllimshme të administratorëve të Shoqërisë apo menaxherët e fondit, për interesa personale dhe në kundërshtim me interesat e Anëtarëve të fondit. Për parandalimin e këtyre veprimeve, Shoqëria Administruese ka hartuar politika e procedura të brendshme dhe ka krijuar mekanizmat e nevojshëm të kontrollit.

- **Risku i depozitarit**

Funksioni i depozitarit kryhet nga një subjekt i licencuar nga AMF siç shpjegohet në seksionin "DEPOZITARI". Megjithatë, për një arsye apo një tjetër, kjo shoqëri nuk mund të përmbushë detyrimet e saj ligjore, dhe në këtë rast disa aktivitete të fondit, si për shembull regjistrimi i aseteve të Fondit apo përlllogaritja e vlerës neto të aseteve, mund të vonohen.

- **Risku i Inflacionit**

Risku i inflacionit përbën riskun që ndryshimet në indeksin e çmimeve në ekonomi mund të japin një ulje të rikthimeve nga investimet nëpërmjet një rënie në fuqinë blerëse të parave të investuara. Në përgjithësi pagesat e obligacioneve ndikohen nga ky risk sepse flukset mund të bazohen në norma fikse interesi, dhe një rritje në inflacion zvogëlon fuqinë blerëse të tyre. Duke ndjekur këtë shembull të obligacioneve, nëse një investitor blen një obligacion 10 vjeçar që paguan një normë interesi në 4%, por inflacioni shkon në 6%, me kalimin e çdo viti obligacionmbajtësi humbet fuqi blerëse nga flukset hyrëse që realizon.

- **Risku Politik**

Risku politik asociohet me ndryshimin në ambientin politik, i cili mund të ketë impakt negativ në të gjithë bizneset e vendit. Njëkohësisht vlerësimet për një mungesë stabiliteti politik në vend, edhe sipas vlerësimeve të jashtme të agjencive të kreditimit, mund të ndikojnë në rritjen e kostove të borxhit dhe rritje të normave të interesit në treg të cilat ndikojnë në çmimin e aseteve të Fondit.

- **Risku i Ndryshimit të Tatimit**

Risku i ndryshimeve të regjimit tatimor përbën riskun e mundësisë së mosrealizimit të rikthimeve të pritshme të parashikuara, duke u bazuar në një regjim të caktuar tatimor në kohën e kryerjes së kontributeve në fond dhe regjimit të ri tatimor që mund të jetë në kohën e tërheqjes nga fondi me arritjen e moshës së pensionit. Kështu, si pasojë e ndryshimit të barrës tatimore mbi të ardhurat financiare në Republikën e Shqipërisë nga 15% që është aktualisht, do të mund të ndryshojë edhe rendimenti neto dhe vlera finale e investimit nga fondi në të ardhmen kur të kryhen pagesat e vlefshme për kontribuesit në fondin e pensionit, duke e ekspozuar investitorin ndaj luhatjes së vlerës neto të kuotave të fondit në të ardhmen.

## RISQE TË TJERA

Krahas risqeve të mësipërme të lidhura me investimin, Shoqëria Administruese mund të përballet edhe me risqe të tjera të biznesit të cilat mund të sjellin humbje për shoqërinë apo dëmtojnë reputacionin e saj, si risku operacional, ligjor, reputacional, dhe risku i përputhshmërisë.

- **Risku Operacional:**

Risku operacional përbën riskun e humbjeve nga mosfunksionimi i sistemeve dhe i procedurave të Fondit, ose nga faktorë të jashtëm. Shoqëria Administruese përpilon procedura të brendshme dhe sisteme kontrolli për minimizimin e riskut operacional.

- **Risku Ligjor:**

Risku ligjor përbën riskun e humbjeve që lindin për shkak të çështjeve ligjore të shkaktuara nga paaftësia e Shoqërisë Administruese për të zbatuar kontratat ligjore, licencat dhe/ose të drejtat e pronësisë.

### • Risku i Reputacionit:

Risku reputacional konsiston në perceptimin e publikut në lidhje me besueshmërinë e Shoqërisë Administruese duke përfshirë impaktin e ngjarjeve specifike të cilat mund të përkeqësojnë apo ndikojnë negativisht perceptimin e publikut për shoqërinë. Humbja e reputacionit mund të sjellë humbje në të ardhura dhe ulje të vlerës së aksionerëve

### • Risku i Përputhshmërisë:

Risku i përputhshmërisë përbën ekspozimin ndaj penalteteve ligjore, gjobave dhe humbjeve materiale me të cilat mund të përballlet Fondi në rast se Shoqëria Administruese nuk arrin të veprojë në përputhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse që rregullojnë veprimtarinë e Fondit, me politikën e brendshme ose me praktikën më të mira të tregut.

## 3.2 RREGULLAT E MENAXHIMIT TË RISKUT

Shoqëria Administruese në mënyrë që të menaxhojë riskun ndaj të cilit është i ekspozuar aktiviteti, ndërmerret masat e mëposhtme:

- Ndarjen e funksioneve të veçanta dhe kontrolleve midis njësisë operative, njësisë së mbikëqyrjes dhe analizës, dhe njësisë prapavijë.
- Krijimin e një kulture ku kuptimi dhe menaxhimi i riskut është përgjegjësia e çdo punonjësi të shoqërisë. Punonjësit e çdo njësie njihen me të gjitha risqet ndaj të cilave ekspozohet shoqëria dhe fondit, si dhe të jenë të gatshëm që të sigurohen që çdo risk që bie mbi njësitë e tyre po menaxhohet sipas politikave dhe procedurave.
- Promovimin dhe mbështetjen për përthithjen dhe zbatimin e praktikave më të mira të menaxhimit të risqeve.
- Krijimin e njësisë së dedikuar për menaxhimin e riskut brenda shoqërisë. Menaxheri i riskut kryen identifikimin, matjen dhe kontrollin, si sasi dhe cilësor të të gjitha llojeve të risqeve që lidhen me fondin dhe aktivitetin e Shoqërisë Administruese, dhe bën menaxhimin dhe raportimin e tyre. Ai kontrollon aktivitetin e Menaxherit të Portofolit në mënyrë që të merren vendimet e duhura për investimet, në përputhje me riskun ekzistues të portofolit dhe jep rekomandime në përputhje me strategjinë e riskut dhe mbajtjen e niveleve të përshtatshme të riskut brenda kufijve përkatës.
- Politika e menaxhimit të riskut udhëhiqet nga natyra e skemës së fondeve dhe tolerancës për risk të përcaktuar në objektivat e investimit të fondit.
- Metodologjitë e vlerësimit të riskut mbështeten në praktikën më të mira, si dhe ligjet, rregulloret dhe standardet kontabël ndërkombëtare.
- Përgjegjësit e proceseve/drejtuesit e njësisë, ose stafi tjetër i përshtatshëm i shoqërisë, kryejnë edhe vetëvlerësime dhe analiza të risqeve operacionale që kanë të bëjnë me linjat e tyre të biznesit, të mbështetur nga njësia e riskut.
- Politika e riskut është ndërtuar mbi një qëndrim gjithëpërfshirës, duke konsideruar jo vetëm riskun e aseteve të fondit dhe të shoqërisë, por të gjithë risqet që hasen nga individët gjatë planifikimit për pension.
- Vendosja dhe monitorimi i kufijve për ekspozimet në risk gjatë aktivitetit dhe transaksioneve të kryera.
- Përmeshja e nevojave për të siguruar buxhetin e nevojshëm për burimet e strukturave dhe sistemeve të menaxhimit të risqeve.
- Krijimi i një emri të mirë dhe besimit tek Anëtarët e fondit, në lidhje me menaxhimin sa më të mirë të fondeve në përputhje me të gjitha rregullat dhe ligjet, dhe duke u bazuar në praktikën më të mira.
- Raportimi dhe përputhshmëria e veprimtarisë me rregulloret dhe kërkesat e autoritetit mbikëqyrës dhe institucioneve të tjera.

#### 4. PERFORMANCA E FONDIT DHE INFORMIMI I PUBLIKUT

Shoqëria Administruese përlogarit çdo ditë Vlerën Neto të Aseteve dhe çmimin e Fondit. Pasi i konfirmon këto të dhëna çdo ditë me Bankën Depozitare, i publikon ato në faqen zyrtare të Shoqërisë (me përjashtim të rasteve kur faqja zyrtare ka probleme të përkohshme teknike, anëtarit mund të informohet me telefon apo pranë zyrës qendrore të Credins Invest). Në faqen zyrtare janë të publikuara edhe raporte periodike mbi të ardhurat historike neto të fondit, të paraqitura me shifra dhe grafikisht, si dhe struktura aktuale e asetëve të fondit me ndarjen në përqindje sipas tipeve të investimeve. Çdo Anëtar i Fondit të Pensionit pajiset me emër përdoruesi dhe fjalëkalim për të aksesuar online kudo dhe në çdo kohë llogarinë e tij në Fond.

#### 5. KONTRIBUTET E ANËTARËVE NË FONDIN E PENSIONIT

##### Pagesat e kontributeve

Pagesa e kontributeve kryhet në monedhën Lek, në mënyrat e mëposhtme:

1. Transfertë nga degët e çdo banke të nivelit të dytë, për në llogarinë e Fondit nr. AL46 2061 1224 0000 1113 1397 9100, pranë Depozitarit Tirana Bank sh.a., kundrejt tarifave në fuqi;
2. Autorizim për pagesa automatike e periodike;
3. Zbritje automatike nga paga.

Pagesat e kontributeve mund të kryhen si pagesë e menjëhershme, mujore, 3 mujore, 6 mujore, vjetore ose në intervale të tjerë të vendosur nga Anëtarit i Fondit. Shuma e kontributit do të jetë jo më pak 1000 (një mijë) lekë në muaj.

##### Kontributet mund të paguhen nga:

- a) Çdo person fizik që është Anëtar në Fond ose nga çdo person tjetër jo Anëtar, në emër dhe për llogari të Anëtarit;
- b) Çdo punëdhënës i cili pasi ka lidhur kontratën me Shoqërinë Administruese kontribuon në emër dhe në favor të punëmarrësve të tij.

##### Ndërprerja e pagesave

Nëse një Anëtar/e në Fond, përkohësisht ose përfundimisht ndërpret pagesën e kontributit, ai/ajo do të vazhdojë të mbetet Anëtar/e në Fond duke ruajtur të njëjtat të drejta si Anëtarët e tjerë.

Shembull i blerjes së një kuote pensioni:

Çmimi i kuotës së pensionit në ditën e kontributit:	1,300.00 lekë
Kontributi:	15,000.00 lekë
Numri i kuotave të anëtarit në Fond: (15,000.00 lekë /1,300.00 lekë )	11.54 kuota

Ky transaksion regjistrohet nga ana e Shoqërisë Administruese në llogarinë individuale të Anëtarit në regjistrin përkatës, të Fondit e cila mbahet paralelisht edhe pranë Depozitarit. Nëse pas disa kohësh çmimi i kuotës do të rritet nga 1,300.00 lekë në 1,350.00 lekë, vlera e asetëve të Anëtarit në Fond (pa tarifën e kostos së administrimit) do të jetë 1,350.00 lekë x 11.54 kuota = 15,579 lekë.

## 6. TRAJTIMI FISKAL

### 6.1 TRAJTIMI FISKAL I FONDIT

Fondi është një grup asetesh, i krijuar në bazë kontrate dhe pa personalitet juridik, për rrjedhojë nuk i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat ose taksës mbi vlerën e shtuar.

### 6.2 TRAJTIMI FISKAL I KONTRIBUTEVE TË BËRA NGA ANËTARËT

Në përputhje me ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 Për Fondet e Pensionit Vullnetar, Neni 88, si dhe ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar):

1. Kontributi i bërë nga çdo Anëtar në Fond zbritet nga të ardhurat personale të tij për efekt tatimi.
2. Kthimi i investimit përfshirë fitimet nga kapitali prej investimeve të kryera me asetet e Fondit nuk i nënshtrohen tatimit, as për vetë Fondin dhe as për Shoqërinë Administruese.
3. Kontributet e bëra nga punëdhënësi dhe çdo kontribues tjetër në emër dhe për llogari të Anëtarit të Fondit për efekte fiskale, nuk vlerësohen si të ardhura personale të Anëtarit.
4. Në rast se Anëtari në Fond është nën 50 vjeç, kufiri maksimal për lehtësitë tatimore për kontributet vjetore, është vlera më e vogël që del nga krahasimi i shumës 200,000 lekë dhe 15% të të ardhurave vjetore bruto të Anëtarit.
5. Në rast se Anëtari është mbi 50 vjeç, kufiri maksimal për lehtësitë tatimore për kontributet vjetore është vlera më e vogël, që del nga krahasimi i shumës 250,000 lekë dhe 25% të të ardhurave vjetore bruto të Anëtarit.

Blerja e kuotave të Fondit është shërbim financiar dhe si rrjedhojë është e përjashtuar nga TVSH. Shërbimet e ofruara nga Depozitari për Shoqërinë Administruese dhe Anëtarët vlerësohen si shërbim financiar dhe si rrjedhojë janë të përjashtuara nga TVSH. Tatimi që shoqëron tërheqjen e parakohshme është sa norma e zbatueshme në çastin e tërheqjes.

### 6.3 TRAJTIMI FISKAL I KONTRIBUTEVE TË BËRA NGA PUNËDHËNËSI

Në përputhje me ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 Për Fondet e Pensionit Vullnetar, Neni 88, si dhe ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar), kontributet e bëra nga punëdhënësi në interes të punëmarrësve të tij në një plan pensioni profesional, vlerësohen shpenzim operativ deri në shumën vjetore për çdo punëmarrës të barabartë me 250,000 lekë dhe kjo shumë vlerësohet shpenzim i zbritshëm për qëllime të tatimit mbi fitimin të punëdhënësit.

### 6.4 TRAJTIMI FISKAL I PËRFITIMEVE TË MARRA NGA ANËTARI

Në përputhje me ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 Për Fondet e Pensionit Vullnetar, Neni 88, si dhe ligjit Nr 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar: Çdo pagesë e marrë nga Anëtari i Fondit në momentin kur mbush kushtet ligjore për përfitim, tatóhet me tatimin mbi të ardhurat personale. Çdo ndryshim ligjor lidhur me trajtimin fiskal, do të reflektohet edhe në prospektin e Fondit.

## 7. PAGESA E PENSIONEVE

Tërheqja e aseteve të akumuluar në llogarinë e Anëtarit mund të bëhet kur Anëtari plotëson kushtet e parashikuara në ligj. Në çdo rast tjetër kemi të bëjmë me tërheqje të parakohshme. Shoqëria Administruese do të ushtrojë edhe veprimtarinë e kryerjes së pagesave të pensionit.

### 7.1 PAGESA E PENSIONIT SIPAS KRITEREVE TË PARASHIKUARA ME LIGJ

Çdo Anëtar i Fondit sipas zgjedhjes ka të drejtë të përfitojë nga pagesa e menjëhershme e vlerës neto të aseteve në llogarinë e tij, ose nga pagesa periodike në formë pensioni që i përgjigjen kësaj vlere, kur përmbush kushtet e mëposhtme:

- 1) Kur mbush moshën e pensionit të parashikuar me ligj për sistemin e pensionit të detyrueshëm që zbatohet për atë Anëtar;
- 2) 5 vjet përpara se të mbushë moshën e pensionit të parashikuar me ligj për sistemin e pensionit të detyrueshëm;
- 3) kur bëhet i paaftë për punë në mënyrë të përhershme dhe që vërtetohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Asetet e akumuluar mund të tërhiqen në format e mëposhtme:

1. marrjen e pagesës së menjëhershme të vlerës neto të aseteve në llogarinë e tij të pensionit ose një pjesë të saj;
2. pagesë periodike e planifikuar në formë pensioni që i përputhet vlerës neto të aseteve;
3. përdorimin e vlerës neto të aseteve të llogarisë së vetë apo të një pjese të saj për blerjen e një kontrate të sigurimit të jetës në formë “të përvitshme” të lëshuar nga një shoqëri e sigurimit të jetës;
4. kombinimin e mënyrave të cituara në pikat 1, 2, dhe 3 më sipër.

Shoqëria administruese e fondit të pensionit i njofton anëtarët 3-muaj para lindjes së të drejtës për përdorimin e aseteve neto në llogarinë e tij të pensionit.

Anëtari i Fondit është i lirë të zgjedhë mënyrën e tërheqjes së aseteve nga llogaria e tij personale. Pagesa e menjëherëshme e vlerës neto të aseteve do të kryhet në bazë të kërkesës me shkrim të Anëtarit në llogarinë e tij jo më vonë se 30 ditë nga marrja e kërkesës.

Pagesat periodike në formë pensioni do të kryhen mbështetur në një marrëveshje të veçantë që do të lidhet midis Anëtarit dhe Shoqërisë Administruese kur Anëtari plotëson kushtet e parashikuara nga Ligji për të përfituar. Periudha kohore më e shkurtër që mund të zbatohet në kontratë për tërheqjen e pagesave periodike është 30 ditë.

Në Aneksin 2, në fund të këtij dokumenti, ilustrohen me shembuj skenarë të ndryshëm se si ndikon kohëzgjatja e periudhës së investimit në Fond (e lidhur kjo me moshën e Anëtarit) në kontributin që duhet të derdhë Anëtari në Fond në mënyrë që të përfitojë një pension të përshtatshëm.

### 7.2 TËRHEQJA E PARAKOHSHME

Nëse Anëtari i Fondit kërkon të tërheqë asetet e akumuluar në llogarinë e tij individuale pa përmbushur kriteret ligjore për të përfituar, kjo konsiderohet tërheqje e parakohshme. Tërheqja e parakohshme shoqërohet me penalitetin e tërheqjes së parakohshme.

**Penaliteti i Tërheqjes së Parakohshme:** Në rastin e tërheqjes së parakohshme Shoqëria Administruese bazuar në ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar”, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, do të aplikojë penalitete të cilat do të llogariten mbi vlerën neto të aseteve të kërkuara për t’u tërhequr para kohe pasi është zbritur tatimi sipas legjislacionit në fuqi në momentin e tërheqjes. Llogaritja do të kryhet në raport me kohëzgjatjen e Anëtarit në Fond dhe më konkretisht:

- a) 2% për çdo tërheqje të parakohshme të kryer pas 20 vitesh nga data e kontributit të parë.
- b) 5% për çdo tërheqje të parakohshme kryer në periudhën kohore që fillon pas 10 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 20 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 20-të;
- c) 10% për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore që fillon pas 5 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 10 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 10-të;
- ç) 15%, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore deri në 5 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 5-të;

Përqindja konkrete e penalitetit për çdo rast sipas përcaktimeve në pikat a,b,c,ç do të llogaritet në mënyrë përpjesëtimore në varësi të periudhës të derdhur të kontributeve.

Për efekt të llogaritjes së penalitetit të tërheqjes së parakohshme, si datë e kontributit të parë do të konsiderohet data e parë e derdhjes së kontributit në fondin e parë të pensionit.

### 7.3 FONDI I PENSIONIT VULLNETAR ËSHTË I TRASHËGUESHËM

Nëse Anëtari ndërron jetë përpara se të marrë pagesën e të gjitha aseteve të veta, asetet në llogarinë e tij do t’i shpërndahen trashëgimtarëve në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë trashëgiminë.

### 7.4 PROCEDURA PËR TËRHEQJEN E ASETEVE NGA LLOGARIA INDIVIDUALE

Në rastin e pagesës së menjëhershme të aseteve të akumuluar në bazë të kërkesës standarde të plotësuar nga Anëtari i Fondit, Shoqëria Administruese i paraqet urdhrin Depozitarit, në mënyrë që ai të kryejë pagesën e totalit të aseteve të akumuluar në llogarinë individuale të Anëtarit brenda 30 ditësh nga depozitimi i dokumentacionit të plotë dhe plotësimi i kërkesës. Në rastin e pagesës periodike të aseteve të akumuluar midis Anëtarit të Fondit dhe Shoqërisë Administruese, do të nënshkruhet një marrëveshje mbi pagesat periodike.

Anëtari i Fondit në mënyrë të pavarur përcakton shumën dhe frekuencat e pagesave periodike të cilat mund të ndryshohen me kërkesën e tij.

Sipas preferencës së Anëtarit shuma e pagesës periodike përcaktohet si numër kuotash ose si vlerë në monedhën Lek.

## 8. PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES SË ANËTARËSISË NË FONDIN E PENSIONIT

Marrëveshja e anëtarësisë në Fond përfundon kur:

1. Anëtari fiton të drejtën për të tërhequr dhe përdorur asetet e akumuluar. Në këtë rast, marrëveshja e anëtarësisë do të përfundojë dhe do të konkludohet një marrëveshje e re, e standardizuar, bazuar mbi mënyrën e tërheqjes dhe përdorimit të aseteve të akumuluar.



2. Anëtari vdes përpara moshës së pensionit.
3. Llogaria e Anëtarit transferohet në një Fond tjetër.

Nëse Anëtari i Fondit ndalon së paguari kontribute ai vazhdon të mbetet Anëtar në Fond.

## 9. TRANSFERIMI I LLOGARISË INDIVIDUALE

Anëtari i Fondit ka të drejtë që në çdo kohë të transferojë asetet e veta nga një fond pensioni në një tjetër i cili administrohet nga e njëjta ose nga një tjetër shoqëri administruese.

Anëtari që ka vendosur të transferojë asetet e veta në një fond të ri pensioni duhet të njoftojë paraprakisht shoqërinë administruese të fondit ekzistues për vendimin e tij. Në këtë rast kontrata me shoqërinë e mëparshme administruese do të përfundojë. Një kontratë e re me shoqërinë e re administruese do të nënshkruhet nga palët. Transferimi i aseteve në Fondin e ri duhet të përfundojë jo më vonë se dita e parë e punës, pas dhjetë (10) ditësh pune pasi Shoqëria Administruese e Fondit të mëparshëm të pensionit ka marrë njoftimin nga Anëtari. Transferimi nuk mund të kryhet nëse detyrimet e Anëtarit ndaj Fondit të mëparshëm nuk janë shlyer.

## 10. TARIFAT E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Tarifa e Administrimit: Tarifa e administrimit të Fondit do të mbahet nga asetet e Fondit. Ajo do të jetë 2 % e vlerës neto të aseteve të Fondit. Tarifa e administrimit do të llogaritet në fund të çdo dite dhe do të mbahet në ditën e fundit të çdo muaji si shumë e të gjitha vlerave ditore të muajit përkatës. Tarifa e administrimit do të llogaritet si përqindje e raportit të vlerës së aseteve neto të Fondit me totalin e ditëve.

Shembull i mbajtjes së tarifës së administrimit nga Shoqëria Administruese:

Shembull		Monedha Lek
Kontributi mujor (a)		10,000.00
Kthimi i supozuar bruto nga investimet (6% norme vjetore)	6%/12	
Interesi përlllogaritur nga investimet (mujor) (b)		50.00
Vlera e kontributit dhe interesave (a+b)		10,050.00
Kosto administrimit për 1 muaj (2% normë vjetore) (c)	2%/12	-16.75
Vlera neto e aseteve në fund të muajit (d)=a+b-c		10,033.25

### Tarifa e transferimit:

Në rastin kur Anëtari i Fondit do të transferojë asetet e tij nga një fond pensioni në një fond pensioni tjetër të menaxhuar nga e njëjta Shoqëri Administruese nuk do të zbatohet tarifë transferimi. Në rastin kur Anëtari i Fondit do të transferojë asetet e tij nga një fond pensioni në një fond pensioni tjetër të menaxhuar nga një shoqëri e re administruese, tarifa e zbatueshme që mbulon koston e transferimit do të jetë në nivelin 0.5% të shumës së transferuar.

Në rastin kur Anëtari transferon asetet në një fond tjetër të pensionit vullnetar, për efekt të llogaritjes së penaliteteve në rastin e tërheqjes së parakohshme të aseteve nga Fondi i ri, në kohëzgjatjen e anëtarësimit do të përfshihet dhe periudha e anëtarësimit në fondin e mëparshëm.

### **Tarifa të tjera:**

Përveç tarifave të sipërpërmendura, Anëtari i Fondit është i detyruar që të kompensojë Shoqërinë Administruese për të gjitha shërbimet shtesë (këtu përfshihet kostoja e dërgimit të pasqyrave shtesë mbi llogaritë individuale me kërkesën e veçantë të Anëtarit, shpenzimet postare, shpenzime të ndryshme bankare, etj.

## **11. DEPOZITARI**

Shoqëria Administruese “Credins Invest” sh.a., ka lidhur një marrëveshje për shërbimin e Depozitarit me Tirana Bank sh.a., me seli në adresën: Rruga “Ibrahim Rugova”, e licencuar nga Banka e Shqipërisë për të ofruar shërbimet e kujdestarisë, depozitimit dhe të besimit me Vendimin nr. 23, datë 24.03.2010, si dhe e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ofruar shërbime depozitimi për fondet e pensionit me licencën Nr. 2 Datë 06.06.2019 (pa afat).

Funksionet e Depozitarit janë si më poshtë:

1. Llogarit vlerën neto të aseteve të Fondit dhe informon Shoqërinë Administruese rregullisht dhe jo më rrallë se një herë në 30 (tridhjetë) ditë për vlerën neto të aseteve të Anëtarëve në Fond;
2. Kontrollon administrimin e aseteve të Fondit nga Shoqëria Administruese në përputhje me dispozitat e kontratës së Fondit (planit të pensionit) dhe të legjislacionit në fuqi. Depozitari nuk duhet të kryejë asnjë veprim të kërkuar nga Shoqëria Administruese që bie në kundërshtim me kontratën e Fondit të pensionit dhe me legjislacionin në fuqi;
3. Siguron që në transaksionet që përfshijnë asetet e Fondit t’i kthehet Fondit çdo përfitim brenda afateve kohore të përcaktuara;
4. Siguron që të gjitha të ardhurat e Fondit shpërndahen në përputhje me kontratën e Fondit dhe me legjislacionin në fuqi.

Depozitari i mban asetet, veprimet dhe dokumentet e Fondit të ndara nga mjetet e veta, veprimet dhe dokumentet e tij.

## **12. EMRI DHE SELIA E AUDITUESIT TË JASHTËM**

Audituesit e jashtëm të Shoqërisë dhe Fondeve nën administrim janë si vijon:

Shoqëria RSM Albania” sh.p.k., me status aktiv në regjistrin e audituesve ligjorë të regjistruar pranë IEKA, me seli në adresën: Rr. “Skender Luarasi”, sheshi Gjenerali Jozef San Martin, Pallati 3, Hyrja 19, 1000, Tiranë  
dhe

Shoqëria Albanian Audit Partners sh.p.k. me status aktiv në regjistrin e audituesve ligjorë të regjistruar pranë IEKA, me seli në adresën: Rr. “Skender Luarasi”, sheshi Gjenerali Jozef San Martin, Pallati 3, Tiranë.

Audituesi i Jashtëm miratohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

## **13. PËRBËRJA E ORGANEVE DREJTUESE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE**

Shoqëria Administruese është shoqëri aksionare, me afat të pacaktuar në të cilën 76% përqind të aksioneve ose të së drejtës së votës janë në pronësi të një banke, konkretisht Bankës Credins sh.a.. Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 95,822,394.00 lekë.

**Organet drejtuese të Shoqërisë Administruese janë:****Asambleja e Aksionarëve:** e përbërë nga:

Banka Credins Sh.a.	76 % të kapitalit aksionar;
SiCRED sh.a.	12 % të kapitalit aksionar;
Estela KOÇI	5 % të kapitalit aksionar;
Egi SANTO	3.5 % të kapitalit aksionar;
Genc KOXHAJ	3.5 % të kapitalit aksionar;

**Këshilli i Administrimit** si organ i vetëm administrimi i cili ushtron njëkohësisht funksionin e administrimit dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë së Shoqërisë (sistemi me një nivel), është i përbërë nga:

1. Znj. Vjosa BODO, Kryetar
2. Z. Eugen NURI, CFA, Anëtar
3. Znj. Estela KOÇI, FCCA, Anëtar
4. Z. Egi SANTO, Anëtar
5. Znj. Armira ÇITOZI, Anëtar

Këshilli i Administrimit kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare dhe zhvillimin e biznesit të Shoqërisë Administruese, kujdeset që Shoqëria Administruese të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit, të shqyrtojë dhe të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë, miraton politikat financiare dhe të investimit, emëron dhe shkarkon Administratorët apo Anëtarët e Komitetit të Investimit si dhe miraton prospektin e Shoqërisë Administruese.

Kryerjen e suksesshme të detyrave të mësipërme e mundësojnë eksperiencia dhe kualifikimet e Anëtarëve, konkretisht:

- 1) Një titull anëtarësie në Institutin CFA (Chartered Financial Analyst-Analist Financiar i Certifikuar) që mbulon menaxhimin e portofolit, fushën e analizës financiare dhe investimeve përkatësisht mbajtur nga Z. Eugen NURI, i cili është me eksperiencë të konsiderueshme në fushën e konsulencës financiare.
- 2) Një titull anëtarësie në shoqërinë globale të ekspertëve kontabël të autorizuar ACCA (Association of Certified Chartered Accountants) që mbulon fushën e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar, sistemit të kontrolleve të brendshëm, menaxhimit të biznesit, mbajtur nga Znj. Estela KOÇI, e cila ka një eksperiencë të gjatë në fushën e auditimit dhe atë financiare.
- 3) Eksperiencia disa-vjecare në fushën ligjore e Znj. Vjosa BODO, e cila është zotëruese e titullit JURIST që prej vitit 2001, në respekt të diplomës së lëshuar nga Universiteti Shtetëror i Tiranës, Fakulteti i DREJTËSISË, si dhe është poseduese e titullit AVOKAT dhe anëtare e dhomës së avokatëve të Tiranës që prej vitit 2003. Gëzon eksperiencë disa vjeçare në projektimin e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe interpretimin e tyre në institucione qendrore shtetërore dhe në shoqëri sigurimi jete me aktivitet në Shqipëri.
- 4) Eksperiencia bankare e Z. Egi SANTO, sidomos në drejtim të vlerësimit dhe promovimit të burimeve njerëzore, plotëson më së miri gamën e përvojës dhe kualifikimeve të Këshillit të Administrimit të Credins Invest.
- 5) Eksperiencia 20 vjeçare në fushën e financës e Znj. Armira ÇITOZI, e cila është zotëruese e titullit “Kontabël i Miratuar”, prej vitit 2005. Znj. Çitozi është një ndër personat kyç në procesin e licencimit të Shoqërisë dhe Fondeve.

Referuar përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009, neni 4/sh “sh), anëtarët e Këshillit të Administrimit, nuk janë palë të lidhura ndërmjet tyre, përveçse të qenit pjesëtar/anëtar i Këshillit të Administrimit të shoqërisë “Credins Invest”.

Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë Administruese është Znj. Estela KOÇI.


Zv. Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë Administruese është Znj. Armira ÇITOZI.

Administratori i Përgjithshëm dhe Zv. Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë janë njëkohësisht edhe Anëtarë të Këshillit të Administrimit. Administratori është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë Administruese, kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë, raporton përpara Këshillit të Administrimit për zbatimin e politikave dhe rregulloreve të brendshme të shoqërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi, vendos mbi të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e punonjësve, dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara në Ligj.

Anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe Drejtuesit e lartë të Shoqërisë kanë deklaruar zyrtarisht pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare se interesat e klientëve të Shoqërisë Administruese, nuk do të çënohen nga asnjë konflikt interesi.

Personeli i Shoqërisë Administruese vepron gjithmonë me profesionalizëm dhe vendos në punë të gjitha njohuritë, në mënyrë të paanshme, të ndershme dhe të pavarur, pa marrë parasysh interesin personal, duke shmangur çdo situatë që është e prirur për të shkaktuar konflikt interesash.

### Organigrama e shoqërisë administruese.



## 14. DELEGIMI I FUNKSIONEVE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Shoqëria Credins Invest sh.a. ka kryer delegimin e funksioneve në vijim, me qëllimin e vetëm të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së shoqërisë dhe cilësisë së kryerjes së këtyre funksioneve. Administrimi me efektivitet i Fondeve nën administrimin e Shoqërisë, kryhet nëpërmjet diversifikimit të investimeve, me synimin e rritjes së kontributeve dhe investimeve në fondet përkatëse. Nxitja e qëndrueshmërisë, sigurisë dhe mirëqeverisjes së aseteve të Fondeve ka qënë dhe është një nga objektivat kryesore të Shoqërisë. Shoqëria Administruese mbetet përgjegjëse për funksionet e deleguara dhe monitorimin /mbarëvajtjen e tyre.

Aktualisht Shoqëria ka marrëveshje për delegimin e funksioneve me:

Shoqërinë “Banka Credins” sh.a.

1. Funksionin e marketimit të Fondit të Pensionit, i cili konsiston në marketimin dhe promovimin e produktit të fondit të pensionit nga Banka Credins dhe rrjeti i degëve.

2. Funksionin e burimeve njerëzore, i cili konsiston në mbështetjen e Shoqërisë Administruese nga ana e Credins Bank sh.a., lidhur me zhvillimin e politikave të burimeve njerëzore në përputhje me objektivat dhe strategjitë e zhvillimit të saj. Gjithashtu siguron pjesëmarrjen në trajnime të punonjësve të Shoqërisë Administruese “Credins Invest” sh.a., bazuar në politikat dhe manualët e Credins Bank sh.a. për këtë qëllim.

3. Funksionin e prokurimeve dhe të mirëmbajtjes. Funksioni i prokurimeve konsiston në suportimin e Shoqërisë Administruese në kontaktet dhe ofertat me të tretët, furnitorë;

Funksioni i mirëmbajtjes konsiston në mbështetjen e Shoqërisë Administruese në lidhje me zgjidhjen e problemeve të ndryshme logjistike të shoqërisë, p.sh. riparime të ndryshme, etj.

4. Funksionin e marketingut, i cili i siguron shoqërisë mbështetjen në fushata të ndryshme publicitare si dhe suportin e kontakteve me të tretët, shoqëri reklamuese, organizuese panairësh, konferencash, evente të ndryshme, etj; Delegimi i këtij funksioni në bazë të marrëveshjes përkatëse është gjithëpërfshirës dhe kryesisht ka lidhje me zhvillimin e marketingut të shoqërisë dhe të të gjitha produkteve të saj.

5. Funksionin e teknologjisë së informacionit, i cili suporton shoqërine në lidhje me administrimin e sistemeve të serverave si dhe në ngritjen, konfigurimin, mirëmbajtjen dhe monitorimin e pajisjeve aktive të rrjetit informativ. Gjithashtu i rekomandon shoqërisë kryerjen sipas rastit të investimeve në networking technologies/solutions të reja për përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese.

6. Funksionin e sigurisë në mjediset e brendshme të Shoqërisë Administruese “Credins Invest” sh.a., për të patur standarde pune të qeta dhe të sigurta;

7. Funksionin e auditimit të brendshëm që bazohet në programin vjetor të punës, i cili është në përputhje me objektivat e kontrollit, dhe miratohet nga Këshilli i Administrimit. Ky funksion kryhet i plotë, duke shërbyer si një funksion i pavarur nga veprimtaria e përditshme ekonomiko-financiare, për të kontrolluar dhe vlerësuar aktivitetin brenda Shoqërisë Credins Invest sh.a.;

8. Funksionin për Disaster Recovery, i cili konsiston në mundësimin e infrastrukturës në lidhje me ambientet dhe pajisjet, si dhe kontribuon në planin e rikuperimit të ambienteve të zyrave dhe pajisjeve.

Funksionet e deleguara janë miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

## 15. NDRYSHIMET NË PROSPEKT

Prospekti i parë është miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Vendimin nr. 173, datë 13.12.2011. Ndryshimi i fundit i prospektit është miratuar me Vendim Bordi nr. 65 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në datë 31.03.2023

**Ky Prospekt i bashkëlidhet kontratës së anëtarësimit në Fondin e Pensionit Vullnetar.**

## ANEKSI 1 - PËRKUFIZIME TË TERMAVE KRYESORE

**Asete** - letra me vlerë, para dhe pasuri të tjera, të cilat janë në pronësi të Anëtarit të Fondit të Pensionit, të shoqërisë administruese apo depozitarit;

**AMF** - Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;

**Anëtar** - personi fizik, në emër dhe në përfitim të të cilit është hapur një llogari pensioni në Fondin e pensionit dhe që ka të drejtë të përfitojë në të ardhmen nga fondi i pensionit në bazë të kontratës me Shoqërinë Administruese, në masën e zotërimit të kuotave;

**Depozitari (banka kujdestare)** - banka e licencuar nga Banka e Shqipërisë, për të ofruar shërbime kujdestarie, depozitimi dhe të besimit si dhe nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për të ofruar shërbime depozitimi për asetet e fondit të pensionit;

**Fond pensioni vullnetar (“fond pensioni”)** – një grup asetesh në pronësi të Anëtarëve të Fondit të Pensionit;

Fitim nga kapitali - të ardhurat nga diferenca e çmimit të asetëve;

**Këshilli i Administrimit** - organi i vetëm i Shoqërisë Administruese me funksione administrimi dhe mbikëqyrjeje;

**Kontribues** - Anëtari në një fond pensioni, punëdhënësi i tij ose çdo person i tretë, i cili paguan kontributet e pensionit në llogarinë e pensionit të Anëtarit të Fondit të Pensionit;

**Kuotë pensioni** - pjesa përpjesëtimore e pronësisë në grupin e asetëve të Fondit të Pensionit. Të gjitha kuotat përfaqësojnë fraksione të barabarta pronësie të asetëve të Fondit të pensionit dhe vlera totale e të gjitha kuotave të Fondit të Pensionit, gjithmonë, është e barabartë me vlerën totale neto të asetëve të këtij Fondi Pensioni;

**Kthim nga investimi** - rezultati, që merret nga investimi i asetëve dhe fitimi nga kapitali;

**Tituj** - janë instrumente financiare të cilët emetohen dhe tregtohen për sigurimin e fitimit, nëpërmjet administrimit të të drejtave që rrjedhin nga zotërimi i tyre. Mund të jenë aksione, obligacione të shoqërive tregtare dhe njësisive vendore, bono thesari dhe obligacione të qeverive, dëftesa tregtare, kuota të fondeve të investimit si edhe instrumente të tjera financiare të krahasueshme me obligacionet dhe aksionet.

**Tituj borxhi** - janë obligacione ose forma të tjera titujsh borxhi të transferueshëm, me përjashtim të instrumenteve financiare që janë ekuivalente me aksionet e shoqërive tregtare ose që nëse konvertohen ose nëse ushtrohen të drejtat që rrjedhin nga to, krijojnë të drejtën e blerjes së aksioneve ose instrumenteve financiare ekuivalente me aksionet.

**Rating (vlerësim) i titujve** - renditje e titujve, e kryer nga agjencitë ndërkombëtare të klasifikimit, sipas nivelit të riskut që lidhet me investimin në to dhe kthimin nga investimi. Titujt e klasifikuar A, A2 dhe A3 përfaqësojnë risk të ulët e për rrjedhim pritshmëria për kthimin nga investimi është e ulët. Titujt të klasifikuar B, BB dhe BBB përfaqësojnë risk mesatar, ndërsa letrat me vlerë të klasifikuar C konsiderohen me risk të lartë e për rrjedhim kanë kthimin më të lartë të pritshëm nga investimi;

**Portofol** - tërësia e investimeve të kryera me asetet e fondit;

Diversifikim i portofolit - investim i asetëve të fondit në instrumente të ndryshëm, në mënyrë që të zvogëlohet risku nga investimi;

**Menaxher i portofolit** - personi përgjegjës në Shoqërinë Administruese për administrimin e portofolit; Përfitime (pagesa e pensionit) - pagesat në para, në momentin e daljes në pension, të shumave, që gjenden në llogarinë individuale të Anëtarit të fondit;

**Plan pensioni** - kontrata ndërmjet individit dhe Shoqërisë Administruese, për ofrimin e përfitimeve për pension.

**Plan pensioni profesional** - kontrata ndërmjet punëdhënësit dhe shoqërisë administruese, për ofrimin e përfitimeve për pension për punonjësit e këtij punëdhënësi;

**Shoqëri Administruese e Fondit të Pensionit Vullnetar (Shoqëri Administruese)** - një Shoqëri Aksionare, e krijuar në përputhje me ligjin e shoqërive tregtare dhe e licencuar nga AMF, për të administruar një ose disa fonde pensioni;

**Transferimi i asetëve** - transferimi i asetëve nga një fond pensioni në një fond tjetër pensioni.

**ANEKSI 2 - SHEMBUJ ILUSTRATIVË TË SKEMËS SË PENSIONIT TË FONDIT**

Këta shembuj dhe të dhënat e paraqitura në to janë verifikuar nga Znj. Petrina DUKA, Aktuare, e autorizuar/njohur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Normat e kthimit dhe kontributet mujore apo vitet e investimit janë marrë thjesht për qëllime ilustrative.

<b>Shembull 1 (Monedha Lek)</b>			
<b>Faza e investimit për pension</b>		<b>Faza e marrjes së pensionit me pagesa periodike</b>	
Kontributet Mujore	10,000.00	Fondet në dispozicion për pension	6,963,629.02
Norma mesatare e interesit ndër vite	4.00%	Norma mesatare e interesit ndër vite	4.00%
Numri i viteve të investimit	30	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	15
Shumë e menjëhershme	-	Numri i kësteve në vit	12
Data e fillimit të pensionit		Shuma e pensionit mujor pas tatimit	43,637.30
Totali i kontributeve	3,600,000.00	Interesi i përfituar gjatë kohëzgjatjes së pensionit	2,277,210.33
Kontributet + Interesat	6,963,629.02	Interesi i përfituar gjatë fazës së investimit	3,363,629.02
Fondet në dispozicion për pension	6,963,629.02	Totali i interesave të përfituar	5,640,839.36

Ndryshim në shumën e menjëhershme

<b>Shembull 2 (Monedha Lek)</b>			
<b>Faza e investimit për pension</b>		<b>Faza e marrjes së pensionit me pagesa periodike</b>	
Kontributet Mujore	10,000.00	Fondet në dispozicion për pension	10,277,127.04
Norma mesatare e interesit ndër vite	4.00%	Norma mesatare e interesit ndër vite	4.00%
Numri i viteve të investimit	30	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	15
Shumë e menjëhershme	10,000.00	Numri i kësteve në vit	12
Data e fillimit të pensionit		Shuma e pensionit mujor pas tatimit	64,401.20
Totali i kontributeve	4,600,000.00	Interesi i përfituar gjatë kohëzgjatjes së pensionit	3,360,773.50
Kontributet + Interesat	10,277,127.04	Interesi i përfituar gjatë fazës së investimit	5,677,127.04
Fondet në dispozicion për pension	10,277,127.04	Totali i interesave të përfituar	9,037,900.54

Ndryshim në pagesën e kontributit mujor

<b>Shembull 3 (Monedha Lek)</b>			
<b>Faza e investimit për pension</b>		<b>Faza e marrjes së pensionit me pagesa periodike</b>	
Kontributet Mujore	15,000.00	Fondet në dispozicion për pension	10,445,443.54
Norma mesatare e interesit ndër vite	4.00%	Norma mesatare e interesit ndër vite	4.00%
Numri i viteve të investimit	30	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	15
Shumë e menjëhershme	-	Numri i kësteve në vit	12
Data e fillimit të pensionit		Shuma e pensionit mujor pas tatimit	65,455.95
Totali i kontributeve	5,400,000.00	Interesi i përfituar gjatë kohëzgjatjes së pensionit	5,845,443.54
Kontributet + Interesat	10,445,443.54	Interesi i përfituar gjatë fazës së investimit	3,415,815.50
Fondet në dispozicion për pension	10,445,443.54	Totali i interesave të përfituar	9,261,259.03

*Shënim: Këta shembuj janë përlllogaritje për qëllime ilustrative dhe nuk përbëjnë garanci apo premtim për shuma apo norma kthimi.*









Credins Invest, Zyra Qendrore  
Rr. "Nikolla Tupe", Nr.1, Kati 3, Tiranë, Shqipëri

[www.credinsinvest.com](http://www.credinsinvest.com)  
[contact@credinsinvest.net](mailto:contact@credinsinvest.net)

Tel: +355 69 60 60 058  
Nuis: K52311009R